

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 317, Datë 12.12.2025

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 174, DATË 29.08.2024
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “FAETHON” SH.P.K., NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.12.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 2539/4 prot., datë 26.11.2025, “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 174, datë 29.08.2024 “Mbi licencimin e shoqërisë “FAETHON” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “FAETHON” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 174, datë 29.08.2024, ka licencuar shoqërinë “FAETHON” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 78.6 MW AC, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 2444, Bashkia Libohovë, Qarku Gjirokastër, për një afat 25-vjeçar.
- Në pikën 2 të vendimit nr. 174/2024 është përcaktuar se shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, jo më vonë se data 14.02.2027.
- Në pikën 3 është përcaktuar se shoqëria “FAETHON” sh.p.k. duhet të raportojë në ERE në mënyrë periodike, çdo 3 muaj, në lidhje me ecurinë e fillimit të punimeve për ndërtimin e parkut fotovoltaiik dhe të dokumentojë fillimin e tyre jo më vonë se data 04.10.2025.
- Në pikën 4 është përcaktuar se ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i administruar

- ERE, me shkresën nr. 2539 prot., datë 29.09.2025, i është drejtuar shoqërisë “FAETHON” sh.p.k., duke i kërkuar informacion për zbatimin e pikës 3 të vendimit nr. 174/2024, në veçanti lidhur me dokumentimin e fillimit të punimeve deri më 04.10.2025.
- Shoqëria “FAETHON” sh.p.k., me shkresën nr. 11 prot., datë 03.10.2025, protokolluar në ERE me nr. 2539/1 prot., datë 06.10.2025, ka bërë me dije se ka aplikuar pranë Agjencisë

së Zhvillimit të Territorit (AZHT) për pajisjen me lejen e zhvillimit dhe në vijim me lejen e ndërtimit, por se deri në atë moment nuk kishte marrë një përgjigje zyrtare dhe për rrjedhojë, nuk kishte filluar ende punimet për ndërtimin e parkut fotovoltaik.

- Në kushtet kur punimet nuk kishin filluar dhe VNM paraprake kishte skaduar më datë 04.10.2025, ERE, me shkresën nr. 2539/2 prot., datë 11.11.2025, i ka kërkuar shoqërisë të informojë nëse disponon një VNM të vlefshme apo ka aplikuar për rinovimin e saj, si dhe të paraqesë informacion në lidhje me raportimet periodike (çdo 3 muaj) pranë MIE dhe AKBN, në zbatim të pikës 1, gërma “gj” të VKM nr. 67, datë 14.02.2024 dhe nenit 9 të kontratës nr. 2427 rep., nr. 1333 kol., datë 05.04.2024, të nënshkruar me MIE.
- Shoqëria “FAETHON” sh.p.k., me shkresën nr. 13 prot., datë 14.11.2025, protokolluar në ERE me nr. 2539/3 prot., datë 18.11.2025, ka sqaruar se studio e projektimit e ngarkuar nga shoqëria është duke punuar për përgatitjen e aplikimit përkatës pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) për rinovimin e VNM-së paraprake dhe se shoqëria do të informojë ERE-n pas depozitimit të aplikimit.
- Po në këtë shkresë, shoqëria ka bërë me dije se, me shkresën e saj nr. 12 prot., datë 13.10.2025, ka njoftuar Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore lidhur me ecurinë e projektit, në përputhje me detyrimet e kontratës me MIE dhe VKM nr. 67/2024.

3. Analiza Ligjore dhe Vlerësimi

- Pika 3 e vendimit nr. 174/2024 parashikon detyrimin për raportim periodik në ERE dhe dokumentimin e fillimit të punimeve jo më vonë se data 04.10.2025, afat i cili është lidhur me vlefshmërinë e deklaratës mjedisore (VNM paraprake).
- Duke qenë se VNM paraprake ka skaduar më datë 04.10.2025, ndërkohë që punimet për ndërtimin e parkut fotovoltaik nuk kanë filluar ende, kushti aktual i pikës 3 nuk mund të përmbushet në formën ekzistuese dhe nuk reflekton më situatën ligjore të projektit.
- Në këtë fazë, detyrimi thelbësor për vijimin e projektit është rinovimi i VNM-së paraprake pranë AKM-së, në përputhje me kuadrin ligjor mjedisor dhe aktet e miratimit të projektit (VKM nr. 67/2024 dhe kontrata me MIE).
- Për rrjedhojë, vlerësohet e nevojshme që pika 3 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 174, datë 29.08.2024, të riformulohet, duke i vendosur shoqërisë “FAETHON” sh.p.k. një afat të qartë dhe të matshëm për depozitimin në ERE të një kopjeje të aplikimit pranë AKM-së për pajisjen me VNM paraprake të rinovuar.

4. Nevoja për Ndryshimin e Vendimit

- Në mbështetje të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë, vlerësohet se:
- Pika 3 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 174, datë 29.08.2024, duhet të ndryshohet, duke kaluar nga një detyrim për dokumentimin e fillimit të punimeve brenda një afati tashmë të tejkaluar, në një detyrim konkret për paraqitjen në ERE të aplikimit pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për rinovimin e VNM-së paraprake, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 3 e vendimit të ERE-s nr. 174, datë 29.08.2024, ndryshohet si vijon: *“Shoqëria ‘FAETHON’ sh.p.k., brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, duhet të depozitojë në ERE një kopje të aplikimit pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për pajisjen me VNM paraprake të rinovuar.”*
2. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme të njoftojë shoqërinë “FAETHON” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, “OST” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a., lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI